

MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT PËR BASHKËPUNIM

NDËRMJET

AKADEMISË DIPLOMATIKE TË

MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME TË

REPUBLIKËS SË KOSOVËS

DHE

AKADEMISË DIPLOMATIKE

TË MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME TË

REPUBLIKËS ÇEKE

Akademia Diplomatike e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës dhe Akademia Diplomatike e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës Çeke (në tekstin e mëtejshëm: “Palët”);

Duke dëshiruar të vendosin dhe zhvillojnë bashkëpunimin në lidhje me hulumtimin e përbashkët dhe trajnimin e stafit diplomatik;

Janë marrë vesh si vijon:

Neni 1

Qëllimi i këtij Memorandumi të Mirëkuptimit për Bashkëpunim (në tekstin e mëtejshëm: “Memorandumi”) është që të ndihmojë në krijimin e kushteve për mbajtjen e kontakteve të rregullta dhe promovimin e bashkëpunimit ndërmjet Palëve. Bashkëpunimi do të bazohet në reciprocitet dhe përfitim të ndërsjellë.

Neni 2

Palët i japin përparësi hulumtimit të përbashkët, prezantimit dhe zhvillimit të metodave bashkëkohore për trajnimin e diplomatëve dhe të specialistëve në fushat e politikës së huaj, marrëdhënieve ndërkombëtare dhe fusha të tjera relevante. Palët zotohen se do ta informojnë njëra tjetrën në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me hulumtimin dhe teknikat e mësimdhënies në fushat e lartpërmendura dhe të shkëmbejnë literaturën dhe botimet përkatëse.

Neni 3

Bashkëpunimi në kuadër të këtij Memorandumi mund të përfshijë:

(a) mbajtjen e përbashkët të kurseve të trajnimit themelor dhe të specializuar;

- (b) shkëmbimin e materialeve të mësimdhënies;
- (c) shkëmbimin e studiuësve ose diplomatëve të rinj me qëllim të rritjes së kualifikimeve të tyre;
- (d) shkëmbimin e njohurive dhe përvojave në idhje me organizimin e mësimdhënies në institucionet akademike;
- (e) konsultimet e përbashkëta mbi kurset e gjuhëve të huaja;
- (f) shkëmbimin e ekspertëve për pjesëmarrje në konferenca, simpoziume dhe panele diskutimi në vendet e njëra tjetrës;
- (g) realizimin e projekteve të përbashkëta në fusha me interes të ndërsjellë;
- (h) organizimin e takimeve për çështje me interes të ndërsjellë ndërmjet përfaqësuesve të të dyja Palëve;
- (i) forma të tjera të bashkëpunimit që mund të vendosen bashkërisht nga Palët.

Neni 4

Përveç nëse merren vesh ndryshe, secila Palë do të jetë përgjegjëse për mbulimin e shpenzimeve që burojnë nga zbatimi i këtij Memorandumi.

Neni 5

Ky Memorandum hyn në fuqi në datën e nënshkrimit. Secila prej Palëve mund të shprehë përmes kanaleve diplomatike dëshirën për të ndërprerë zbatimin e këtij Memorandumi nga një datë e caktuar. Njoftimi për këtë duhet të bëhet të paktën tre muaj paraprakisht. Çështja e programeve të papërfundura do të zgjidhet me marrëveshjen e Palëve.

Lidhur në Prishtinë, Republika e Kosovës, më 30 maj 2016, në dy kopje, në gjuhën angleze.

Në emër të Akademisë Diplomatike

të Ministrisë së Punëve të Jashtme

të Republikës së Kosovës

Skender Durmishi, Drejtor i Përgjithshëm

Akademia Diplomatike

Në emër të Akademisë Diplomatike

të Ministrisë së Punëve të Jashtme

të Republikës Çeke

Ivo Šilhavý, I ngarkuar i përkohshëm

në Ambasadën e Republikës Çeke në

Prishtinë